


Fjaleburri



Angazhimi i Burrave dhe
Djemve kundër Dhunës me
bazë Gjinore në Shqipëri

Rreth nesh



QSSL
Qendra për Studime Sociale e Ligjore
Tiranë | Shqipëri

Qendra për Studime Sociale e Ligjore (QSSL) themeluar në vitin 2008, është një konsulencë teknike e ngritur mbi eksperiencën kombëtare dhe ndërkombëtare të themeluesve. QSSL sjell metodologjitë më të fundit në hulumtime ligjore e sociale në Shqipëri, Kosovë e më gjerë. Fokusi është në të drejtat e njeriut, institutionet dhe zhvillimin socio-ekonomik.



QFS
Qendra Fëmijët Sot
Tiranë | Shqipëri

Qendra Fëmijët Sot (QFS) është një organizatë jo fitimprurëse Shqiptare e themeluar në 2007 dhe punon për një botë ku fëmijët të realizojnë potencialin e tyre të plotë. QFS ka publikuar studime të ndryshme, manuale dhe raporte që synojnë të ngrejnë kapacitetet e institucioneve shtetërore të cilat punojnë me/për fëmijët, të inkurajojnë pjesëmarrje aktive dhe ti mbrojnë fëmijët nga dhuna.

Mirënjohje



*Empowered lives.
Resilient nations.*



United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women

Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit “Promovimi i ideve të reja në përfshirjen e djemve dhe burrave në sfidën ndaj stereotipeve gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore” i mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (PNUD), Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), dhe me mbështetjen financiare të Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Qendra për Studime Sociale dhe Ligjore (QSSL) dhe Qendra Fëmijët Sot (QFS).

Opinionet dhe këndvështrimet e shprehura në këtë studim nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (PNUD), Entitetit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), apo të Kombeve të Bashkuara (OKB).

Përmbajtja

Rreth dokumentit

Ky raport paraqet një përmbledhje të aktiviteteve dhe gjetjeve kryesore nga studimi me temë "Fëmija është babai i njeriut". Ky ishte një studim i projektuar dhe udhëhequr nga Qendra për Studime Sociale e Ligjore (QSSL) në bashkëpunim me Qendrën Fëmijët Sot (QFS) dhe i zbatuar në dy zona të vendit, Dibër dhe Durrës. Gjithashtu studimi u zhvillua edhe nëpërmjet faqeve të internetit, duke përfshirë kështu të gjithë Shqipërinë dhe përtej saj. Raporti paraqet konkluzione dhe rekomandime për punën në të ardhmen me synim që burrat dhe gratë së bashku të angazhohen në parandalimin e dhunës kundër grave dhe vajzave në Shqipëri.

Organizimi i Studimit

06

Përmbledhje



Metodologjia

09



08

Parathënie

04

Aktivitete dhe Gjetje

12

Aktivitetet



Rekomandime

32



20

Qëndrimet & ndikimi

05

Përmbledhje

“Fëmija është babai i njeriut” ishte një studim me kampjon të vogël mbi dhunën me bazë gjinore në Shqipëri. Ky studim është konceptuar dhe udhëhequr nga QSSL dhe realizuar nga QSSL në bashkëpunim me QFS. Studimi u zhvillua gjatë periudhës së aktiviteteve ‘16 Ditë Kundër Dhunës Gjinore’ në nëntor 2012, dhe u shtri në vijim deri në maj 2013. Aktivitetet u përqendruan në veprimtari hulumtuese me pjesëmarrjen e djemve, burrave, grave dhe vajzave në zonat Dibër dhe Durrës, si dhe në angazhimin përmes faqes së internetit të cilatdo të interesuar.

Ky projekt u konceptua si një studim mbi qëndrimet shoqërore mbi te cilat duhet të bazohet drejtimi që duhet të marrin ndërhyrjet kundër dhunës me bazë gjinore (DhBGj) ne te ardhmen, në të cilat do të përfshihen burrat dhe djemtë në Shqipëri. Qëllimi kryesor ishte angazhimi i burrave dhe djemve në këto çështje, gjetja e rrugëve për ti dhënë shtysë angazhimit të tyre në parandalimin e dhunës kundër grave dhe nxitjen e barazisë gjinore. Në themel të këtij qëllimi të projektit ishte koncepti i ndikimit të grupimeve shoqërore të vogla por të përkushtuara që të sjellin ndryshime shoqërore. Punëtorite edukative mbi çështjet gjinore dhe DhBGj përfshinë kryesisht burra dhe djem. Metodologjia u bazua në hulumtimin me pjesëmarrje për të sjelle ndryshim, dhe struktura e aktiviteteve përfshinte:

- *Ftesë*: thirrje e hapur për të gjithë burrat dhe djemtë nga të gjitha shtresat shoqërore për të marrë pjesë në projekt.
- *Përfshirje*: angazhimi i burrave dhe djemve në eksplorimin e mënyrave të mundshme për të parandaluar dhunën kundër grave dhe vajzave.
- *Frymëzim*: mbështetje për të krijuar një rrjet me burra dhe djem që do të udhëheqin ndryshimin mes bashkëmoshatareve të tyre, si gjetja e mekanizmave për të realizuar këtë.

Studimi ka vlerë si hulumtim edukues dhe informativ për të gjitha studimet dhe ndërhyrjet që do të ndërmerren në të ardhmen. Megjithatë, studimi ka kufizime të cilat së pari lidhen me shkallën e vogël të kampjonit. Rekomandimet e këtij studimi përfshijnë ndërtimin e një teorie ndryshimi me angazhimin e burrave, kryerjen e studimeve kombëtare për këtë, koordinimin e fushatave informuese ku vihet theksi tek mesazhet kundër-dhunë po aq sa dhe kundër-dhunës me bazë gjinore, mbështetjen dhe ngritjen e rrjeteve me pjesëmarrje lokale, me leadership nga individë aktivë në jetën publike në komunitet si dhe zgjerimin e horizontit të tyre, për të promovuar pjesëmarrjen e burrave në këtë fushë.

Shkurtime

GEM Gender equitable men assessment scale (shkalla e matjes së normave të barazisë gjinore tek meshkujt)

DhBGj Dhunë me Bazë gjinore

DhKG Dhuna Kundër Grave

DhPI Dhuna e partnerëve Intimë

FShB Fushata e Fjongos së Bardhë

INSTAT Instituti Shqiptar i Statistikave

PNUD Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin

Parathënie

“Fëmija është Babai i Njeriut”

Studimi u konceptua si një hulumtim me pjesëmarrje që synon të sjellë ndryshim në qëndrimet e burrave dhe djemve dhe synon të ndikojë në drejtimet që duhet të marrë adresimi i DhBGj në Shqipëri në të ardhmen. Duke kuptuar perspektivat dhe sistemin e vlerave, qëllimi kryesor ishte angazhimi i burrave dhe djemve me synim promovimin e barazisë gjinore dhe për të gjetur mënyra për t'i mbështetur ata në lidhshmëri lokale në ndalimin e dhunës ndaj grave.

Aktivitetet e studimit u projektuan me qëllim që të ftohen, përfshihen dhe frymëzohen burrat dhe djemtë për të vepruar. Me këtë qëllim u përpoqëm të kuptojmë nxitësit socialë të informimit të cilat do të bënin të mundur kapërcimin e plogështise aktuale. Ne krijuam modelet e qëndrimeve të vetë-raportuara dhe ekzaminuam modelet e ndikimit në nivel lokal. Aktivitetet dhe puna në grup si dhe fushata rriten ndërgjegjësimin dhe diskutimet mes djemve dhe burrave për rolet gjinore dhe barazinë. Projekti me sukses:

- **Ftoi:** përmes shkollave dhe komuniteteve, një total prej 275 djem, 268 burra dhe 163 vajza, të cilët plotësuan pyetësin e studimit. Përveç kësaj, fushata në rrjetet sociale arriti të angazhojë mbi 9000 persona. Kjo na dha mundësinë që të masim përdorimin e materialeve që adresonin DhBGj në internet dhe të modelonim ndikimin përmes rrjeteve sociale.

- **Përfshiu:** punëtorë të specializuar edukative për komunitetin të cilat u projektuan dhe zhvilluan në një mjedis ku tema e identitetit dhe marrëdhëniet sociale mund të eksplororeshin në mënyrë të sigurt dhe pa presione. Kishte 32 pjesëmarrës nga Durrësi dhe 41 nga Dibra.

- **Frymëzoi:** burrat dhe djemtë që të demonstrojnë lidhshmëri në këtë çështje. Pjesëmarrësit propozuan ide për të adresuar mbizotërimin e dhunës kundër grave në komunitetet e tyre. Pothuajse një e treta e burrave dhe djemve pjesëmarrës dhanë fjalën që do jone aktive për të vepruar kundër DhBGj në të ardhmen.

Metodologjia

Hulumtim empirik

Përgjigjet subjektive të burrave, djemve dhe vajzave mbi qëndrimet kundër dhunës u mbledhën përmes kërkimit empirik. Kjo u realizua përmes një pyetësi të bazuar mbi 'GEM Scale', me disa ndryshime me qëllim që të reflektohej konteksti dhe kultura Shqiptare¹.

Punëtoritë

Disa punëtorë edukative të profilizuara u zhvilluan kryesisht me burra e djem dhe u përqendruan në çështje kundër DhBGj. Metodologjia e këtyre punëtorëve u bazua në parimet e hulumtimit me pjesëmarrje ku u përfshinë teknika të reja loje, në të cilat pjesëmarrësit inkurajohen që të rishikojnë e sfidojnë qëndrimet brenda një strukture të caktuar konceptuale.

Duhet përmendur se

Studimi ka vlerë si kërkim formues që shqyrton interesat, tiparet dhe nevojat e grupeve dhe individëve në komunitet. Kjo mund të na ndihmojë të identifikojmë dhe të kuptojmë dinamikat lokale për të hartuar programe specifike në përshtatje me nevojat lokale. Ndonëse për shkak të kampionit të vogël të studimit mund të ketë kufizime, përgjithësimet mbi jetën e përditëshme na lejojnë që të themi me bindje se gjetjet e këtij studimi kanë vlefshmëri për të gjithë popullsinë.

Pyetësi nuk kishte si qëllim mbledhjen e të dhënave socio-ekonomike, pasi kjo u supozua si variabël i pandryshueshem përgjatë periudhës kur u realizua studimi. Pjesëmarrësit nuk u zgjedhën në mënyrë të rastësishme, por u vetepërzgjedhën në çdo fazë të studimit. Qëllimi i projektit për të identifikuar meshkuj të cilët mund të mbështeteshin për të udhëhequr ndryshimin i dha projektit dhe studimit një frymë pozitive. Rezultatet e punëtorëve u shënuan në çdo fazë. Ato nuk u vlerësuan në grupe kontrolli apo aktivitete sistematike para dhe pas studimit. Si rrjedhim studimi nuk shqyrtoi potencialin e ndikimit të paragjykimëve sociale në angazhimin apo në përgjigjet e dhena.

DhBGj në Shqipëri

Niveli i dhunës

Dhuna ndaj grave dhe vajzave mbetet e përhapur në të gjitha shtresat shoqërore në Shqipëri. Gati 56% e grave dhe vajzave të moshave 15 deri në 49 vjeç kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës në familje (Dhuna në familje në Shqipëri: një studim kombëtar, INSTAT, 2009). Sipas policisë së shtetit shqiptar në 64% të rasteve viktimë e dhunës në familje është gruaja, dhe më pas vijnë fëmijët, prindërit dhe individë të tjerë të pranishëm në familje. Raste të dhunës së shkaktuar kundrejt burrit dhe dhunës midis vëllezërve dhe motrave mbeten shumë më pak të raportuara.

Qëndrimet ndaj dhunës

Nga studimi Shqiptar Demografik dhe Shëndetësor 2008-2009 dimë se:

1. Mundësia e justifikimit të DhBGj ndaj grave shkon në përpjestim të zhdrejtë me statusin e ulët socio-ekonomik;
2. Meshkujt kanë më shumë gjasa të arsyetojnë përdorimin e dhunës sesa femrat;
3. Zakonet dhe vlerat sociale rrisin shkallën e pranimet të DhBGj;

Fondi i Besimit i Kombeve të Bashkuara 2010-2013 vuri në dukje nevojën për të punuar me anëtarë të komunitetit, sidomos me burra dhe djem, për të bërë dhunën me bazë gjinore të papranueshme nga ana shoqërore. Rekomandimet përfshijnë nevojën për të kuptuar arsyet e shkaktarëve të dhunës në familje dhe ato të burrave për të ushtruar dhunë, si dhe kryerjen e një studimi të gjerë mbarëkombëtar me përfshirjen e burrave dhe djemve kundër dhunës në Shqipëri. Studimi Fjale Burri në këtë rast kontribuon në njohuritë egzistuese dhe i merr në konsideratë këto rekomandime.

010

Arsyetimi

Pakicat e dedikuara

Në themel të këtij studimi është koncepti i ndikimit të pakicave të dedikuara ndaj nje kauze për të sjellë ndryshime shoqërore. Ky na tregon se për të sjellë ndryshime në kohë nuk nevojitet medoemos të ndryshosh menjëherë opinionin e shumicës. Mbështetja e kësaj pakice të dedikuar kërkon të kuptohen më mirë qëndrimet, të identifikohen dhe angazhohen liderët e mundshëm si dhe të shqyrtohen mekanizma që ndikojnë tek burrat dhe djemtë.



Konsensusi social

“opinion i mbizotërues i shumicës në një popullatë mund të përmbysset shpejt nga një fraksion i vogël i agjentësh të shpërndarë në mënyre rastësore të cilët në mënyrë të vazhdueshme kundërshtojnë opinionet e pranuar gjerësisht dhe nuk ndikohen nga mendimet e shumicës”

[Lexo: Xie | Screenivan | Korniss | Zhang | Lim | Szymanski
<http://arxiv.org/pdf/1102.3931v2.pdf>]



Pika ku arrihet ndryshimi

Në teori, vlerat shoqërore përgjithësisht të pranuar mund të ndryshohen me shpejtësi me vetëm një pakicë prej 10% të popullsisë. Kjo do të thote, se në Shqipëri, përveç mbështetjes së grave, në nivel komuniteti një grup i vogël burrash dhe djemsh duhet të angazhohen, të ngrenë zërin dhe të veprojnë kundër DhBGj.

011

Aktivitetet

Aktivitetet u projektuan në mënyrë që burrat dhe djemtë të shprehin lirisht se çfarë ata konsiderojnë të nevojshme sa i përket informacionit, burimeve dhe mbështetjes për të kapërcyer barrierat personale dhe shoqërore në mënyrë që të sjellin ndryshime. Studimi u realizua në tre faza themelore:

- **Ftesa:** nxënësit, vajza dhe djem, u ftuan përmes shkollës së tyre të plotësonin pyetësin. Një version më i zgjeruar iu dha edhe familjeve të tyre për të cilat ne kërkuam që i anketuari të ishte mundësisht babai ose një anëtar mashkull në familje. Kjo ishte e rëndësishme për shkak se pyetësi përmbante një seksion në të cilin diskutohej marrëdhënia babë e bir. Të gjithë pyetësit përmbanin një ftesë të hapur për të marrë pjesë në aktivitetet e mëvonshme. Një fushatë online u zhvillua për të rritur gjerësisht ndërgjegjësimin dhe angazhimin.

- **Përfshirja:** punëtoritë patën si qëllim eksplorimin e qëndrimeve dhe adresuan çështje të cilat u ngritën nga pjesëmarrësit. Aktivitetet u projektuan mbi bazën e gjetjeve të dala nga pyetësoret të cilat u prezantuan dhe u diskutuan në fillim të çdo punëtorie. Aktivitetet e tjera përdorën teknika loje me qëllim që pjesëmarrësit të qëndronin të angazhuar si individë dhe si grup.

- **Frymëzimi:** teknikat e lojës u planifikuan që mendimet dhe diskutimet të ktheheshin në veprime në fazën përfundimtare të këtij studimi: çfarë kemi zbuluar dhe si propozojmë ta trajtojmë atë. Pjesëmarrësit u inkurajuan të shqyrtojnë çështje që lidhen me lidhshimin mes meshkujve të rritur dhe të rinj, si dhe modelet që ata do të ndiqnin. Çështje të tjera që u diskutuan ishin festimi i ditës kombëtare për baballarët dhe krijimi një simboli kombëtar kundër DhBGJ, apo përshtatja e një simboli ndërkombëtar, si p.sh Fjongoja e bardhë.

012

Fushata Online

Fjalë Burri

Si pjesë të studimit zhvilluam një fushatë përmes një faqe interneti dhe Facebook. Kjo na dha mundësinë që të përfshinim dhe diasporën shqiptare, duke i dhënë kështu studimit një nivel kombëtar. Fushata ishte kundër-DhBGJ, e bazuar në fjalën e urtë shqiptare "Burri lidhet prej fjale!" Ne ju kërkuam pjesëmarrësve online të japin fjalën e tyre duke klikuar 'pëlqej' ose duke e shpërndarë mesazhin në rrjetet e tyre sociale. Kjo na mundësoi ne të bëjmë vlerësim të angazhimit të tyre me materjale kundër DhBGJ. Analiza e rrjetit social na dha profilizim të vizitorit dhe mënyrat si transmetohet informacioni (në numër) dhe si ndodh ndikimi (përmes ndarjes), përfshi këtu pjesëmarrësit në nivelin lokal të cilët ishin angazhuar edhe online.



Faqja e Internetit

www.fjaleburri.net

Vizitorë: Shqipëri (70%), Zvicër, Itali, SHBA, Gjermani.
Vendndodhjet në Shqipëri: Tiranë (63%), Durrës (12%), Shkodër (10%), Vlorë (7%).

Veprimet ('pëlqej', 'google+', 'Twitter'): 1.5% e vizitorëve.
Analiza: 11% e vizitorëve nuk ndërvepruan fare me temën në faqen e studimit në internet.



Facebook

Profilet e Miqve

Vendndodhja: Shqipëri (85%), Itali (10%), Zvicër, SHBA, MB.

Femra 52% | Meshkuj 48%.

Meshkuj: 39% beqarë | 11% në një marrëdhënie | 50% të martuar.
Femra: 18% beqare | 23% në një marrëdhënie | 59% të martuara.
Moshë: më i riu/e reja 17 vjeç | më i madhi/e madhja në moshë 57 vjeç | Moshë mesatare: 30 vjeç.

Shoqëri e përbashkët: mesatarisht: 5 | më e zgjeruara: 33.

Klikimet javore: 360-1140 | miq të fansave: 24,763.

013

Pyetësori

Pyetësori u shpërnda në shkolla të mesme në Dibër dhe në Durrës. Pyetësori u bazua në GEM ndërkombëtar, por u përshtat me kontekstin dhe kulturën shqiptare me qëllim që të siguronte të dhëna që adresojnë temën e dhunës, maskilitetin në shoqëri, marrëdhëniet dhe rolet gjinore. Pyetësori përmbante 25 pyetje me zgjedhje (po/ jo/ nuk e di), pesë pyetje të hapura dhe një pyetje me mundësi zgjedhjeje. Pyetjet përfshinin:

Dhuna

- ◇ Dhuna ndodh edhe nëse nuk ka lëndime fizike
- ◇ Në rast se shikon një njeri që godet një femër ju duhet ta ndaloni atë
- ◇ Një burrë nuk duhet të ngrejë dore kundër një femre
- ◇ Është e drejta juaj për të kthyer dorë në rast se goditeni
- ◇ Ndonjëherë goditja është e vetmja mënyrë për të shprehur ndjenjat

Maskiliteti

- ◇ Mbi të gjitha burri duhet respektuar
- ◇ Një burrë gjithmonë meriton respektin e gruas dhe fëmijëve të tij
- ◇ Një burrë që nuk lufton kur është i nënvlerësuar është një njeri i dobët
- ◇ Është e natyrshme që burrat të sillen në mënyrë agresive

Marrëdhëniet në rolet gjinore

- ◇ Burrat dhe gratë duhet të kenë role të barabarta në familje
- ◇ Tradita ku burri shikohet si kryetari i familjes duhet mbajtur
- ◇ Edhe burrat janë në gjendje për t'u kujdesur për fëmijët ashtu sikurse gratë
- ◇ Mënyra se si një burrë e trajton gruan e tij është një çështje që i takon vetëm atij
- ◇ Gruaja duhet të tolerojë dhunën me qëllim mbajtjen e familjes së bashkuar
- ◇ Kur një burrë dhe një grua martohen, gruaja bëhet pronë e burrit

014

Analizë

Përgjigjet e pyetësorit u koduan përpara analizës. Për të analizuar dhe interpretuar të dhënat me përgjigje tre opsionale u përdorën statistikat përshkruese dhe analizat e frekuencës, teknikat shumevariable për kategori të dhënash duke përdorur psh. Spearmans Rho për bashkë-variancën dhe korrelacionin.

Analizat parashikuese CHAID dhe teknikat e të mësuarit mekanik u përdorën për të krijuar shoqërizim dhe modele të besimit. Analiza cilësore e tekstit u përdor për të interpretuar pyetjet e hapura.

Dibër

94 burra, 66 djem dhe 86 vajza plotësuan pyetësorët. Gjinia u vetëraportua. 19 pyetësorët në të cilët të dhënat ishin të paplota nuk u konsideruan në analizën e pyetësorëve në Dibër.



Shkollat pjesëmarrëse në plotësimin e pyetësorit ishin: "Slova", Gjimnazi i Peshkopisë dhe Shkolla Pedagogjike në Peshkopi.

Durrës

174 burra, 209 djem dhe 77 vajza plotësuan pyetësorin. Gjinia u vetëraportua.

Shkollat pjesëmarrëse në plotësimin e pyetësorit ishin: "Hysen Çela", "Naim Frashëri", "Gjergj Kastrioti" dhe "Jan Kukuzeli".



015

Punëtoritë

Gjetjet nga pyetësorët orientuan përgatitjen e një serie punëtorish që u zhvilluan në nivel lokal.

Pjesëmarrja në to ishte e hapur dhe aktivitetet përfshinin:

1) Punëtori edukative ku u përfshinë djem dhe vajza në ambiente shkollore ku u diskutua mbi kuptimin e maskilitetit, marrëdhëniet gjinore dhe dhunën kundër grave.

2) Punëtori me komunitetin, ku morën pjesë djem, burra dhe gra nga komuniteti i gjerë dhe ku u adresuan qëndrimet gjinore, dhuna kundër grave dhe u eksploruan ide se si mund të nxitet ndryshimi në nivel lokal. Punëtorite u orientuan drejt:

◇ **Eksplorimit të qëndrimeve:** zbulimi i fakteve, shkaqeve dhe motiveve. Si i tejkalojmë ndryshimet të cilat komplikojnë marrëdhëniet? Si të krijojmë respekt të ndërsjellë? Mënyrat se si ne kushtëzohemi nga mjedisi ynë shoqëror dhe kulturor, u eksploruan nëpërmjet lojërave, si p.sh numërimi alfabetik në vend të atij numerik. Gjithashtu u ndanë shembuj se si jemi kushtëzuar nga ajo që na “është mësuar”, dhe u fol mbi mungesën e dëshirës së njerëzve për të reaguar kur nuk ndihen të sigurt nga diçka apo kanë frikë se po bëjnë diçka “gabim”.

◇ **Kuptimit të ndikimit përmes bindjes,** marrëdhëniet shoqërore dhe pengesat ndaj ndryshimeve u shpalosën përmes aktiviteteve që vunë theksin tek një qëllim i përbashkët i punës në grup psh: loja me sy mbyllur.

◇ **Diskutimit të ideve:** kush ndikon tek ne? Cilat janë modelet lokale që ndjekim? Propozime se si të kapërcehet dhuna; simbolet kombëtare që mund të përdoren në fushata kundër dhunës; propozime të tilla si gjethja e borzilokut dhe fjongoja e bardhë; mendimi i pjesëmarrësve pse dita e babait nuk festohet në Shqipëri.

◇ **Arritjes së ndryshimit:** Të ngresh zërin: si reagojmë në luftën kundër dhunës? Të kuptojmë qëndrimet konformiste para dhe pas-seminarit. Ku të gjendet mbështetja tek institucionet vendore dhe komuniteti? Si të përfshihesh: identifikimi i liderëve, modelet që frymëzojnë për të sjellë ndryshime dhe marrja e një roli aktiv. Në fund të fundit: burri lidhet prej fjale! A mund ta jepni fjalën tuaj tani?

016

Pjesëmarrja

Pjesëmarrja efektive varet nga krijimi i një ambienti të sigurt në të cilin mund të zhvillohen diskutime të lira, të ndershme dhe të singërta. Kjo u arrit me një axhendë strikte për punëtoritë me kufij të qartë mbi angazhimin e pjesëmarrësve në fillim të seancave të punëtorive. Në përputhje me këto rregulla, pjesëmarrësit u nxitën të bëhen protagonistë në diskutimet dhe aktivitetet që u zhvilluan. Në këto diskutime dhe aktivitete pjesëmarrësit u drejtuan nga dy lehtësues në çdo takim.

Lehtësimi i shpërndarjes dhe plotësimit të pyetësorëve si dhe organizmi i punëtorive u koordinua nga Argitra Vizion në Dibër dhe Shoqata e Grave me Probleme Sociale në Durrës.

Pjesëmarrësit

Numri i pjesëmarrësve në punëtori në Dibër ishte 41 dhe në Durrës 32. Në punëtoritë e zhvilluara me nxënës të shkollave morën pjesë të rinj të moshave 13 deri në 19 vjeç. Në këto aktivitete kishte edhe vajza, por pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin djem.



Punëtoritë me pjesëmarrje nga komuniteti përfshinin pjesëmarrës nga qeverisja vendore, shoqëria civile, prindërit dhe fëmijët e shkollave. Kjo pjesëmarrje krijoi një dinamikë interesante në rastet kur baballarë dhe djemtë (familje), burra dhe grate (bashkëshortë) morën pjesë në të njëjtat aktivitete.




017

Gjetjet shkurtimisht




Dhuna:

- ◊ Ne se shikoni një burrë që godet një femër duhet të ndërhyni
- ◊ Një burrë nuk duhet të ngrëjë kurrë dorë ndaj një femre
- ◊ Është e drejtë të godasësh për të marrë hak



Maskiliteti:

- ◊ Një burrë gjithmonë meriton respektin e gruas dhe fëmijëve të tij
- ◊ Një burrë që nuk lufton kur është i nënvlerësuar është i dobët
- ◊ Është e natyrshme për një burrë të veproje në mënyrë agresive



Gender roles:

- ◊ Mënyra se si një burrë e trajton gruan e tij është një punë e tij
- ◊ Gra duhet të tolerojë dhunën për të mbajtur të bashkuar familjen e saj
- ◊ Gruaja është pronë e burrit të saj

020

	• Djem	• Burra	• Vajza
Dakord:	76%	75%	81%
Dakord:	61%	55%	80%
Dakord:	46%	39%	26%

Gati gjysma e djemve mbeshtesin përdorimin e dhunës si hakmarrje. Kjo kategori kishte korrelacion të lartë me ata që kundërshtonin faktin se një burrë nuk duhet të ngrëjë kurrë dorë ndaj një femre. Megjithatë, siç rezultoi nga punëtoritë shumë nga ata që mbështesnin qëndrimet e dhunshme gjithashtu afirmuan se dhuna ishte mënyra kryesore për të ndërhyrë e ndaluar një situatë DhBGj.

	• Djem	• Burra	• Vajza
Dakord:	84%	82%	70%
Dakord:	46%	54%	35%
Dakord:	9%	8%	7%

Statusi është i rëndësishëm për meshkujt, sidomos brenda familjes. Pavarësisht se pranohet në përgjithësi që burrat nuk janë natyrshëm agresivë, pothuajse gjysma e burrave dhe e djemve thanë se burrat e kanë të nevojshme të luftojnë që të ruajnë respektin ndaj statusit të tyre.

	• Djem	• Burra	• Vajza
Dakord:	26%	35%	13%
Dakord:	31%	45%	23%
Dakord:	28%	35%	15%

Një përqindje e konsiderueshme e djemve dhe burrave pasqyruan besimin e tyre se gruaja nuk ka status të barabartë me burrin. Ky besim shtrihet në vazhdimësi që nga nevoja për grate që tja lenë vendim marrjen burrave deri tek gati çereku i djemve të anketuar që u shprehën se gruaja bëhet pronë e burrit pas martesë.

Rezultatet e mësipërme janë mesatare për dy zonat Dibër dhe Durrës.

021

Dhuna

Si e përkufizojnë dhunën burrat dhe djemtë?

Duke pasur në vëmendje edhe hulumtime të mëparshme ndërkombëtare*, qëndrimet e burrave dhe djemve shqiptarë ndaj dhunës e abuzimit në familje janë komplekse, jo të qarta, dhe ndonjë herë kontradiktore. Ndërsa shumica e të rinjve kanë një qasje negative ndaj dhunës dhe abuzimit, disa lloje të dhunës dhe dhunën në situata të caktuara e konsiderojnë të pranueshme ose të justifikueshme.

Një numër i konsiderueshëm burrash dhe djemsh besojnë se dhuna ndodh edhe në rast se nuk ka dëmtime fizike. Gjatë punësive u vu re se kërcënimi me dhunë dhe sjelljet frikësuese kanë ndikim të madh tek i dhunuari ose viktimi, siç në fakt edhe synohet të kenë. Një burrë pjesëmarrës në seminar theksoi se “fjalët mund të lëndojnë edhe më gjatë se sa dëmtimi fizik”.Fjala Vret!

Të dhënat e anketimeve zbuluan se faktorët socialë normativë lidhen me qëndrimet që mbështesin dhunën. Për shembull, mosha rezultoi si një pararendës i rëndësishëm i një sërë përgjigjesh të anketës. Kjo ishte gjetje e paparashikuar pasi te rinjtë kishin qëndrime më mbështetëse ndaj dhunës krahasuar me të anketuarit burra, gjë që nuk pritej. Nga ana tjetër, te rinjtë që e shohin dhunën si një formë shprehje ishin sa gjysma e numrit të burrave që ndanin po këtë qëndrim. (djemtë 7% dhe burrat 14%).


Rezultati i anketimit, sipas të cilit pranimi dhe mbështetja në një shkallë të lartë e dhunës sugjeron që iniciativat në të ardhmen që synojnë të adresojnë DhBGj duhet të përfshihen dhe transmetohen në kontekstin e një mesazhi edhe më të gjerë anti-dhunë.

*c.f. Burton, S, et al. (1998) Supporting Women and Challenging Men.


Diferencat lokale

Ndryshimet rajonale mes grupmohave në kampjonin në Durrës dhe Dibër tregojnë për ndryshime të mëdha në qëndrime, edhe pse ato ishin më shumë në sasi se sa në natyrën e qëndrimit. Në Dibër kishte korrelacion më të madh mes grupmohave sesa tek të anketuarit në Durrës, gjë që tregon se në Dibër të anketuarit ndajnë më shumë vlera të njëjta në lidhje me çështjet për të cilat u anketuan.

Korrelacioni i përgjigjeve të anketës midis burrave dhe djemve në Durrës dhe Dibër është më i lartë tek djemtë në Dibër dhe burrat në Durrës.



Korrelacioni tregon një ngjashmëri të lartë në përgjigje mes burrave në Dibër por të ulët në Durrës.



Pyetje	Djemtë në Durrës	Burrat në Durrës	Burrat në Durrës	Burrat në Dibër
Është e drejtë të hakmerresh kur provokohesh?	56%	36%	43%	35%
Një mashkull që nuk lufton kur nënvlerësohet është i dobët?	52%	41%	44%	34%
Partneret kanë përgjegjësi për punët e shtëpisë	87%	76%	87%	86%
Burrat duhet të kenë fjalën e fundit	43%	32%	47%	53%
Duhet të ndikoni të DhBGj	79%	74%	82%	68%
Një burrë nuk duhet të ngrejë kurrë dorë ndaj një femre	74%	48%	65%	45%
Një femër duhet të tolerojë dhunën për të mbajtur familjen e saj	24%	39%	30%	59%
Një femër është pronë e burrit	23%	32%	30%	40%
% e burrave dhe djemve që iu përgjigjën pyetësorit				

DhBGj

Çfarë është DhBGj?

Si burrat dhe të rinjtë të përfshirë në këtë studim pranuan se burrat janë kryesisht shkaktarë të DhBGj në Shqipëri, ashtu sikurse në çdo vend tjetër të botës. Gjithashtu, shumica e tyre konsideron se dhuna dhe abuzimi ndaj gruas është i papranueshëm.* Megjithatë, edhe ata të cilët e shprehën këtë parim, thanë se dhuna ndaj një femre mund të jetë e pranueshme në disa rrethana të caktuara të tilla si psh: "provokimi". Si nga të dhënat e pyetësorit, ashtu dhe nga diskutimet në grup rezultoi se për një pakicë të caktuar disa forma të dhunës shpesh herë interpretohen si "normale", "të natyrshme", "të pranueshme", "të justifikueshme" dhe jo të dëmshme apo abuzive. Duke konsideruar këto kushte nuk është e vështirë për të parë se si këto forma të sjelljes mund të tolerohen apo të neglizhohen.

Sa e përhapur është DhBGj dhe kush e kryen atë?

Në cilat raste njerëzit mendojnë se ushtrimi i forcës fizike ndaj grave është i justifikueshëm? Për shembull të detyrosh partnerin të kryejë marrëdhënie seksuale me forcë, nga anketuesit me moshë më të madhe konsiderohej dukshëm si një akt dhune në familje, më shumë sesa të anketuarit me moshë të re. Ushtrimi i dhunës fizike ndaj gruas apo partneres shihej shumë më pak si e justifikueshme nga burrat se sa nga djemtë.


Po ashtu, kontrolli i jetës shoqërore të partneres duke i ndaluar kontaktet me familjen dhe miqtë apo kontrolli i partneres duke i mohuar mbajtjen e parave, shihet si dhunë në familje dhe mjaft serioze më shumë nga të anketuarit e moshës më të madhe. Kjo konfirmon gjetje nga studime të tjera që tregojnë se dhuna në familje shpesh mund të injorohet apo tolerohet si çështje kulturore, gjë që bën që të rinjtë të fajësojnë grate për dhunën e burrave ndaj tyre.

* Burman, E. et al. (2004) "Culture' as a Barrier to Service Provision and Delivery: Domestic Violence Services for Minoritized Women", *Critical Social Policy* vol. 24 no. 3 332-357.

Modelimi i qëndrimeve

Negative dhe pozitive

Individët që ushtrojnë DhBGj kanë ide mjaft të ndryshme nga publiku i gjerë. (Gwartney-Gibbs & Stockard:1989) Ata që shpалosin qëndrime që pranojnë dhunën janë më shumë të prirur të ushtrojnë dhunë. (Nabors, Dietz & Jasinski 2006; Cercone, Beach & Arias 2005). Ne aplikua analiza parashikuese në të dhënat e pyetësorit në këtë studim për të eksploruar dy modele qëndrimi, njëri që justifikon DhBGj dhe tjetri që reagon në mënyrë aktive kundër DhBGj përmes shfaqjes hapur të vlerave ku ata besojnë.




Përgjigjet e pyetësoreve -pema e vendimeve. Degëzimi i përmes përfaqëson përgjigjet po/jo. Ngjyrat e pikave përfaqësojnë një pyetje.

Angazhimi kundër DHBGj

Të dhënat e studimit tregojnë se ka një tension mes përgjegjësisë sociale dhe privatësisë. Mbi 25% e atyre që thanë se nuk do të përfshiheshin ndonjë herë në situata të DhBGj ose nuk e dinin nëse do të ndërhyjnë në një situatë DhBGj (pika roze L1) gjithashtu mbajtën kryesisht qëndrime anti-dhunë. Kjo sugjeron se duke pasur orientimin dhe mbështetjen e duhur, këta persona mund të nxiten për të vepruar pozitivisht.

Validimi i DhBGj

Studimi tregon se ka lidhje mes qëndrimeve dhe mendësisë. Disa njerëz mendojnë se dhuna mund të justifikohet dhe të falet. Kjo kishte lidhje me qëndrimet ndaj strukturës së familjes dhe rolet gjinore. Mbi 30% e atyre që besojnë se femra është pronë e burrit (pika me ngjyrë të purpurt L1), ka gjasa të besojnë se burri mund të godasë gruan (pika me ngjyrë blu L5).



Modeli parashikues i pyetësorit - U aplikua filtër për mbështetjen dhe kurajon për të gjetur modelin më dominant mes një tërësie modelesh. Trashësia e degëzimit është treguesi më i dukshëm i numrit të përgjigjeve të parashikuara.

Maskiliteti

Të dhënat e anketës tregojnë se vetëm 9% e djemve dhe 8% e burrave konsiderojnë të natyrshme që një burrë të veprojnë në mënyrë agresive. Ndaj, arsyet se për se burrat mund të veprojnë agresivisht u eksploruan në punëtori po ashtu si dhe skenarët nëse qëndrimet ndaj dhunës mund të lidhen me idenë e maskilitetit.

Maskiliteti është i rrënjësor në perceptimin e statusit, dhe dhuna apo kërcënim i ushtrimit të saj perceptohet si një mjet, megjithëse tipikisht ekstrem, i ruajtjes apo mbrojtjes së këtij statusi. 40-50% e të anketuarve mendojnë se burri e humbet respektin nëse nuk i përgjigjet dhunes me dhune. Sigurisht, këtë perceptim nuk e ndajnë në të njëjtin nivel edhe vajzat. Që burri ka nevojë dhe gjithmonë e meriton respektin e familjes, konsiderohet si e vërtetë nga burrat dhe djemtë, edhe pse vajzat natyrisht kishin pikepamje paksa të ndryshme.

Rezultatet tregojnë se ka një ndryshim të madh mes brezash në lidhje me pranimin e dhunës: djemtë treguan një tendencë më të lartë të tolerojnë dhunën, në krahasim me burrat në Dibër dhe në Durrës. Ndoshta, eksperiencia e jetës dhe pjekuria luajnë një rol të rëndësishëm në zbutjen e qëndrimeve (burra 31% | djem 42%). Kjo sugjeron nevojën e promovimit të modeleve lokale pozitive, modele që duhen gjetur mes njerëzve më të pjekur dhe të cilët do të mund të përcjellin mesazhin anti-dhunë në komunitetin e tyre, si dhe nevojën e forcimit të sanksioneve ligjore- sociale në rastet e DhBGj.

026

Pikëpamjet e vajzave

Perspektivat gjinore


Një gjetje befasuese ishte shkalla e lartë e pranimin të dhunës dhe DhBGj nga vajzat. Ky studim nuk mund të investigonte më tej, nëse kjo gjetje ishte një tregues i përvojës familjare për vajzat apo i normave shoqërore. Gjithashtu, shkalla e korrelacionit midis përgjigjeve të dhëna nga vajzat dhe atyre të dhëna nga djemtë e burrat ishte më e lartë në zonën e Dibrës se në Durrës. Përgjigjet e vajzave në Durrës dukshëm nuk ndërlidhen me përgjigjet e meshkujve.

Edhe pse vajzat ishin më pak mbështetëse ndaj

dhunës krahasuar me djemtë, vajzat në Dibër kishin dukshme mes përgjigjeve të vajzave dhe meshkujve në Dibër, por jo në rastin e Durrësit.

më shumë të ngjarë ta falnin dhunën se sa vajzat në Durrës. Gjithsesi 10% besonin se dhuna është vetëm fizike, një mesatare prej 48% mendonin se është e drejtë të luftosh për të mbrojtur reputacionin me forcë dhe është e drejtë të hakmerresh, pasi është një mënyrë për të shprehur ndjenjat (Durrës 7%; Dibër 14%). Një numër i vogël i konsideron meshkujt agresivë nga natyra (Durrës 4%; Dibër 10%), ndërsa 30% në Durrës dhe 41% në Dibër

Përgjigjet e pyetësorit mbi ndërlidhjen (vijat me ngjyrë rozë dhe fashat e konfidencës) mes vajzave, burrave dhe djemve në Durrës dhe Dibër tregojnë ngjashmëri



mendojnë se burrat humbasin respektin nëse nuk e mbrojnë reputacionin qoftë edhe në mënyrë agresive.

Më alarmante ishte se edhe pse shumica dërrmuese u shpreh se një burrë nuk duhet të ngrëjë kurrë dorën ndaj një femre (Durrës 91%, Dibër 70%), 8% e vajzave në Durrës dhe 27% në Dibër u shprehën kundër. Një pakicë e konsiderueshme e vajzave gjithashtu besonte se një grua duhet të tolerojë dhunën për të mbajtur familjen të bashkuar (Durrës 13%, Dibër 33%).

027

Rolet gjinore

Edhe pse të anketuarit u përgjigjën qartazi se besojnë shumë në përgjegjësi të barabarta mes burrit dhe gruas, kjo nuk do të thotë se rolet e burrave dhe grave duhet të jenë të njëjta apo edhe të mbivendosen. Për shembull, një e treta e burrave, ose nuk e mendojnë ose nuk janë të sigurt që një burrë mund të kujdeset për fëmijën e vet. Siç u shpreh një shumicë e caktuar, burri duhet të ketë kontrollin financiar në familje (30% djem, 36% burra), dhe duhet të ketë fjalën e fundit në vendimet familjare (37% djem, 50% burra).

Edhe pse disa vajza ishin të pasigurta, shumica e tyre mendonin se burri duhet të marrë vendimet në familje. Ne arritëm në rezultatin se tradita ku burri është kreu i familjes nuk reflekton rezultatin e CENSUS 2011 sipas të cilit ndryshimet demografike kanë sjellë një rritje të grave si kryefamiljare kryesisht për shkak të migrimit apo për shkak të familjeve të ndara.

Pjesemarresit në punëtoritë ritheksuan besimin e shprehur në pyetësor (30% djemve; 41% burra; 18% vajza) se është e drejtë dhe e nevojshme për një femër që të tolerojë deri në një pikë të caktuar dhunën për hir të mbajtjes së familjes të bashkuar, por sigurisht duhet të ketë një kufizim deri në çfarë pike duhet të tolerojë.

Kjo u analizua në këndvështrimin e pritshmërive moderne shoqërore ku ju kushtua vemendje këndvështrimeve subjektive se sa vlerave të mbajtjes së një familje të bashkuar dhe punës së përbashkët për harmoninë familjare. Me qëllim që të shihnim efektin e sugjestionit tek ndikimi, ne e bëmë këtë pyetje në dy vende të ndryshme në pyetësor, në pyetjen e nëntë dhe me një ndryshim të lehtë në formulim dhe theks në pyetjen e njëzetë e dytë.

Duhet theksuar se pyetësi iu dha të anketuarve pa ndonjë shpjegim për pyetjet dhe nuk iu tregua atyre qëllimi i anketimit apo studimit. Efekti i pyetjes sugjestive ishte i dukshëm: në pyetjen e 22-të, pasi i kishin dhënë përgjigje një sërë pyetjesh testuese mbi gjininë dhe dhunën, të anketuarit dhanë shumë më pak përgjigje pohuese. Kjo mund të shpjegohet ose me një reflektim më të thellë nga ana e të anketuarve mbi pyetjet, ose me një vetë-censurë, edhe pse kjo e fundit ndoshta ka më pak gjasa duke marrë në konsideratë që pyetësi ishte anonim.

Megjithatë, çështja e statusit të pabarabartë ka një rëndësi të madhe për DhBGj. Vlerat tradicionale sipas të cilave gruaja shihet

si një pronë janë të lidhura fort me qëndrimet se DhBGj është një çështje e brendshme familjare dhe jo një çështje për mbarë shoqërinë. Pyetja nëse gruaja pasi martohet bëhet pronë e burrit nxiti debate të nxehta gjatë punëtorive. Në anketë 30% e djemve, 18% e vajzave, 42% e burrave iu përgjigjën pozitivisht kësaj, edhe pse grupet në Dibër treguan një nivel dukshëm më të lartë besimi krahasuar me Durrësin.

Gjate punëtorive, ky rezultat i pyetësorëve hasi fillimisht në mohim dhe mosbesim. Gjithsesi, pas diskutimeve pjesëmarrësit arritën në konkluzionin se 'edhe pse nuk na pëlqen fakti, kur përballemi me shifra (këtë përqindje) duhet të përballemi me atë çfarë mendojmë, edhe pse e kundërshtojmë kurrë nëse e kemi thënë këtë: është koha ta pranojmë realitetin e mendimit tonë dhe adresojmë atë dhe jo të fshihemi pastymnajtës'.

Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve shprehën qëndrimin se është punë e burrit mënyra si e trajton gruan e tij (26% djem; 13% vajza; 35% burra), një konkluzion që rezultoi edhe nga diskutimet gjatë seminareve ku u theksua se DhBGj gjerësisht konceptohet si një çështje e brendshme dhe jo një sëmundje apo problem social. Ky rezultat duhet konsideruar në rastet e fushatave që synojnë të sjellin ndryshim: ai ndikon shumë në mënyrën se si duhen qasur

këto fushata. Nuk është habi që ky besim është i lidhur edhe me ngurrimin për të ndërhyrë në rast se shohin raste të DhBGj. Për një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të dy gjinive, fakti i të qenit dëshmitar i një rasti dhune nuk është i mjaftueshëm për t'u shqetësuar dhe për të ndërhyrë, pavarësisht shkakut të dhunës.

Në Dibër 8% e djemve dhe 19% e burrave nuk do të ngrinin zerin në një rast të tillë apo nuk do të vepronin. Gjithashtu, shqetësuese është edhe se një tjetër 15% e djemve dhe vajzave nuk e dinin ose ishin të pasigurt se si do të vepronin në një rast të tillë. Për ata persona të cilët u shprehen se do të vepronin, pikëpamjet mbizotëruese, të shprehura gjatë seminareve, ishin se ndërhyrja e tyre do të ishte gjithashtu e dhunshme.

Ata të cilët ishin shprehur se ishin tolerante ndaj dhunës, shfaqën premisën se do të vepronin në një situatë të tillë duke përdorur edhe ata vetë dhunën. Kjo sugjeron gjithashtu nevojën për informim dhe mbështetje komunitare mbi atë se si duhet të ndërhyhet në një situatë në mënyrë jo të dhunshme, ku të kërkesha ndihmë dhe mbështetje, dhe si mund të rrisësh ndërgjegjësimin mbi alternativat e mundshme të ndihmës për viktimat e dhunës.

Ndikimi

Ndryshimi i sjelljes zakonisht ndikon në ndryshimet në qëndrime. Gjetja kryesore e këtij studimi është se ka mungesë serioze informacioni për sa kohë burrat dhe djemtë shprehen se janë të paqartë ose të pavendosur. Në këtë kontekst sugjerimet dhe informacionet sociale janë të rëndësishme për sjelljen e ndryshimeve pozitive.

Në lidhje me informimin, ka nevojë për më shumë ndërgjegjësim mbi të drejtat e grave, me qëllim që të kuptohen më mirë modelet e barazisë në familjen moderne dhe impaktet dhe pasojat e DhBGj. Në mbështetje të kësaj, mënyra se si përcillet mesazhi konsiderohet vendimtar për efektivitetin e tij. Në punetori u vu re se djemtë dhe burrat reagojnë negativisht ndaj nxitjeve dhe mesazheve negative. Kjo nuk do të thotë se ata nuk duhet të dëgjojnë mesazhe të tilla si p.sh. që burrat janë autorët kryesorë të dhunës dhe DhBGj. Gjatë aktiviteteve temat e caktuara dhe kuptimi i perspektives kulturore të pjesëmarrësve rezultoi thelbësor për ruajtjen e një qasje që respekton diskutimet

dhe iniciativat angazhuese të pjesëmarrësve.

Burrat dhe djemtë reagojnë pozitivisht kur iu tha se kjo nuk është një lojë për të gjetur fajtorin apo dhunuesin dhe se ata kanë një rol të rëndësishëm në krijimin e një shoqërie më të sigurt dhe më të mirë për fëmijët e tyre. Ndikimi më i madh social tek djemtë dhe burrat ndodh nga bashkëmoshataret e tyre në nivel komunitar, dhe jo aq në nivelin e fushatave mediatike. Në fushatën online “Fjalë Burri” vumë re se burrat nuk e përcjellin mesazhin e fushatës tek të tjerë, dhe kryesisht ata ftoheshin nga kontaktet femra dhe nga shoqëria e tyre online për t’u bërë pjesë e kësaj fushate. Në këtë kuptim, ndoshta iniciativa për të adresuar DhBGj duhet të maksimizojnë ndikimin duke u përcjellë përmes personave që më shumë ndikojnë, dhe që në këtë rast janë femrat.

Puna në dy zonat gjeografike përgjatë punëtorive ofroi mundësinë e identifikimit të liderëve të mundshëm. Gjatë lojërave me diskutime pjesëmarrësit sollën emra

të cilët do të dëshironin të kishin mbështetje dhe udhëheqje për të adresuar dhunën kundra grave.

Kishte një mungesë të dukshme të modeleve në komunitetet ku jetonin pjesëmarrësit në këtë studim. VIP-at nuk konsideroheshin si modele për tu marrë shembull nga shoqëria edhe pse shpesh ata vihen në krye të fushatave anti-DhBGj: “ndikimi i tyre zgjat sa zgjat reklama dhe nuk ka asnjë efekt tek ne”.

Burrat sugjeruan se djemtë mund të gjejnë persona model mes mësuesve në shkollat e tyre ose edhe mes bashkëmoshatarëve të tyre. Megjithatë djemtë e ndjenin se ata kishin nevojë të gjenin personin që mund të ishte si model për ta në jetën e tyre të përditshme, në radhë të parë mes prindërve të tyre. Djemtë u shprehën se nuk kalonin kohë cilësore me prindërit, kohë si babai me djalin; edhe se mësuesit nuk shprehnin ndonjë interes kujdestarie përkundrejt nxënësve të tyre përtej orës së mësimdhënjes. Aq më të pakta ishin shanset që djemtë të gjenin modele të përshtatëshme mes klasës së politikanëve lokalë për shumë çështje të tjera jo vetëm

për çështjen e DhBGj. Këto konsiderata duhen vlerësuar me kujdes në rastet e ndërhyrjeve të ardhshme kundra DhBGj, me qëllim krijimin e modeleve të cilat mund të kenë një rol të rëndësishëm tek djemtë dhe përgjithësisht në shoqëri. Një fushatë e vetme që përçon një mesazh me anë të personave VIP ose një fushatë online mund të përcillet tek shoqëria dhe ka rëndësi, por nese vetëm, impakti i saj është i ulët.

Ndoshta është e nevojshme që të kërkohen liderë nëpër institucionet vendore të cilët mund të marrin më shumë përgjegjësi mbi supere me qëllim që të arrijnë të lidhen me komunitetin për të gjetur rrugët më të mira për të promovuar barazinë gjinore dhe për të drejtuar luftën kundër DhBGj. Angazhimi qytetar është gjithashtu shumë i rëndësishëm - ndërsa një numër pjesëmarrësish vullnetarisht propozuan të udhëheqin iniciativat vendore kundra DhBGj, kjo përçoi më shumë optimizëm dhe sens të lartë të detyrës dhe shpresë mes djemve sesa mes burrave. Optimizmi i djemve ka nevojë të kanalizohet në drejtimin e duhur për të arritur një ndryshim social afatgjatë.

Rekomandime

Dhuna në familje është kudo dhe kurdoherë një problem si për femrat dhe për meshkujt në çfarëdo lloj forme që ajo merr, edhe pse disproporcionalisht prek vajzat dhe gratë. Fushatat e mëparshme në Shqipëri kanë qenë të suksesshme në rritjen e ndërgjegjësimit mbi çështjen e dhunës kundra grave dhe vajzave. Megjithatë, pa përfshirjen e gjerë të burrave dhe djemve ekziston rreziku që kjo të shikohet si një çështje marginale dhe si një problem vetëm 'i grave'. Në shumë vende, iniciativat e ndërmarra kanë treguar se mund të arrihet progres në rast se burrat angazhohen si pjesë e zgjidhjes më mirë se sa të stigmatizohen si pjesë e problemit përmes veprimit ose mosveprimit.

Studimi ynë tregon disa ndryshime gjeografike të rëndësishme mbi qëndrimet ndaj DhBGj, të cilat ishin surprizuese për disa gjetje, ndërsa disa te tjera ishin më pak të tilla. Punëtorite përforcuan rezultatet e pyetësorëve, edhe pse kur të dhënat iu bënë të njohura pjesëmarrësve, ata nuk e kishin të lehtë të pranonin fakte të pakëndshme në lidhje me qëndrimet mbizotëruese ndaj DhBGj, ose tolerimit të gjerë të DhBGj në zonën e tyre. Gjetje të tilla tregojnë se ka nevojë për qasje me bazë territoriale për të adresuar DhBGj me qëllim që të ato të kenë gjasa të jenë efektive. Nje gjetje themelore nga kërkimet e mëparshme tregon një korrelacion mes qëndrimeve mbështetëse ndaj dhunës dhe besimeve rreth barazisë gjinore dhe marrëdhënieve gjinore. Qëndrimet ndaj barazisë gjinore u maten drejtpërdrejtë në këtë studim dhe tregojnë se edhe pse ka dy dekada punë të shoqërisë civile dhe iniciativa të qeverisë në fushën e promovimit të barazisë gjinore, barazia gjinore prapë ka një mbështetje të dobët ose jo reale në Shqipëri. Mungesa e besimit në barazinë gjinore u shfaq si një pararendës i rëndësishëm i qëndrimeve mbështetëse ndaj dhunës mes elementëve të tjerë të përfshirë në studim. Ata që kanë qëndrime pranuese ndaj dhunës kanë me shumë probabilitet të përfshihen në sjellje të dhunshme.

[vazhdon në fq.34]

Sill ndryshimin!

Histori e suksesshme

"Ne nuk duhet të dyshojmë se një grup i vogël njerëzish me mendime të thella, dedikim e me ideale mund të ndryshojnë botën". *Margaret Mead*

Ndryshimi në lidhje me DhBGj duhet të jetë transformues, që do të thotë: një gjë që nuk ka kthim mbrapa! Me qëllim që të krijohet një rrjet i burrave dhe djemve që do çojnë përpara një ndryshim rrënjësor e masiv e që të këtë rezultate afatgjata, do të duhet:



Një teori ndryshimi për DhBGj

që modelon forcat dhe nxit ndryshim dhe është në thelb të ndërhyrjeve të ardhshme. Kjo teori ka nevojë të zhvillohet në kontekstin shqiptar dhe të përshtatet me parametrat lokalë ndërkohë që gjithsesi shembujt ndërkombëtarë na shërbejnë për orientim.



Të kemi mesazhet e duhura

- duhet të përpunojmë mesazhet që jepen dhe të ofrojmë informacione e sugjerime të përshtatshme dhe në kohë, si pjesë e një strategjie gjithëpërfshirëse.

- duhet të zhvillojmë aktivitete efektive dhe që angazhojnë kryesisht popullatën nën 35 vjeç përmes nxitësve pozitivë dhe teknikave të lojzimit.

Natyrisht kishte dukshëm një tolerancë më të madhe ndaj DhBGj në përgjigjet e pyetësorit me shkrim krahasuar me tolerancën e shfaqur gjatë punëtorive, për shkak të vetë seleksionimit në pjesëmarrje dhe natyrës ndër-personale të aktiviteteve. Njerëzit, natyrshëm prirën të shfaqin qëndrime më shumë konformiste dhe pozitive kur janë në grup, se sa në situata anonimi.

Në fund të aktiviteteve, pjesëmarrësit djem, burra dhe gra u pajtuan me mendimin se edhe pse vete ata nuk mendonin që kishin besime që mbështesnin dhunën, gjetjet e studimit në të vërtetë tregojnë një tablo korrekte të komunitetit të tyre dhe se kjo do të thotë që kjo gjendje së pari duhet të pranohet fillimisht nga komuniteti përpara se të adresohet. Pranimi dhe mbështetja e gjerë ndaj dhunës sugjeron se iniciativat kundër DhBGj në të ardhmen duhet të adresohen në një kontekst më të gjerë mesazhi anti-dhunë. Asnjë formë e dhunës nuk duhet toleruar, por veçanërisht DhBGj .

Duhet bërë studime kombëtare mbi dhunën e adoleshentëve dhe të rinjve, si dhe për nevojat e të rinjve, si në rastin kur ata janë viktime ashtu edhe kur janë dhunues. Puna bashkërenduese mes institucioneve është e rëndësishme në mënyrë që të jetë efektive ndaj djemve të rinj dhe burrave: kjo punë duhet të fokusohet në specifikat e iniciativave dhe fushatave ekzistuese.

Shumica e të rinjve dhe burrave pjesëmarrës në studim theksuan se ndikimi i fushatave është i kufizuar për sa i perket arritjes së ndryshimit të qëndrimeve ndaj dhunës. Ndërhyrjet, për këtë arsye, duhet të përqëndrohen në punën me të rinjtë se sa thjesht në punën mbi ta. Në këtë kuptim, aktivitetet në formë loje në punëtori rezultuan një instrument i dobishëm në identifikimin e lidershit, dhe keto mekanizma duhet të shtrihen edhe në fushatat online.

Në targetimin e fushatave edukative ka nevojë për të reduktuar paqartësinë në lidhje me çfarë është dhuna, duke siguruar informacionin faktik për të sfiduar mitet dhe besimet e pasakta që mund të ekzistojnë brenda komunitetit. Ato gjithashtu duhet të sigurojnë një mesazh të qëndrueshëm, të saktë dhe të qartë në lidhje me përhapjen e DhBGj, si dhe ndikimet e saj. Theksi duhet të vihet mbi atë se si mund të raportohet DhBGj dhe për këtë duhet të ketë udhëzime për ndihmë direkte në komunitet. Në këtë drejtim, fushatat duhet të bëjnë kujdes që të mos nxisin ndërhyrje personale apo komunitare të dhunëshme, por të ndërgjegjësojnë se adresimi behet përmes ligjit dhe mbështetjes shoqërore. Mesazhe fushatash të tilla duhet të përforcohen

me një mesazh anti-dhunë, sepse burrat dhe djemtë të cilët mund të ndërhyjnë në një situatë DhBGj mund ta lidhin këtë me ndërhyrjen e dhunshme! Në kontekstin shqiptar kjo duhet të jetë veçanërisht e ndjeshme, me qëllim që të mos keqkuptohet si rast për 'të bërë vetgjyqësi', ku dhuna përshkallëzohet, ose justifikohet si e bazuar në Kanun. Në të vërtetë, idetë e maskilitetit dhe qëndrimeve ndaj gjinisë po ndryshojnë siç shihet në dallimet në mes brezave, burrave dhe djemve.

Natyrisht, shoqëria shqiptare mbetet mjaft patriarkale: një pakicë e konsiderueshme e djemve dhe burrave (dhe madje edhe disa vajza) i konsiderojnë gratë si pronë e burrit për shembull. Ne mund t'i konsiderojmë këto qëndrime si artefakte kulturore të Kanunit historik që do të shpërbëhen me kalimin e kohës. Megjithatë, drejtimi në të cilin ndryshojnë qëndrimet shoqërore jo domosdoshmërisht është në të mirën e përbashkët të shoqërisë. Ky studim tregoi për shembull, se edhe pse djemtë kanë një qëndrim më 'modern' dhe ndërgjegjësim më të madh ndaj barazisë gjinore se sa burrat, ata kanë më shumë gjasa për të ruajtur qëndrimet tolerante ndaj dhunës. Në këtë drejtim, besimet mbizotëruese dhe normat kulturore mund dhe duhet të ngacmohen dhe sfidohen në mënyrë që të transformohet qëndrimi dhe të përmirësohet roli i grave në shoqëri.

Kjo na çon të kuptojmë vlerat mbizotëruese në njësinë familjare ku etërit janë modele për fëmijët në përgjithësi dhe në veçanti për djemtë. Gjetjet nga ky studim sugjerojnë se baballarët shqiptarë nuk kalojnë shumë kohë me fëmijët e tyre. Djemtë shprehen se ata mësojnë prej etërve të tyre, qoftë nëpërmjet bashkëveprimit apo edhe mungesës së saj. Në këtë drejtim, është përgjegjësi e prindërve, dhe më shumë e baballarëve që të qartësojnë veten mbi vlerat që duan t'u kalojnë bijve të tyre. Baballarët duhet të marrin një rol më pro-aktiv në formimin e djemve të tyre, dhe kjo duhet të ndodhë në të gjitha mjediset, në mënyrën se si babai komunikon me gruan në familje, në kohën që kalon me djalit si për shembull duke u angazhuar në veprimtari sportive dhe aktivitete argëtuese; në shfaqjen e interesit ndaj djalit dhe të qenit i pranishëm në aktivitetet e preferuara të djemve edhe kur jo domosdoshmërisht babai ndan interes për atë aktivitet -'une pëlqej futbollin por babai im jo'. Deri sa baballarët ta kuptojnë se sa i rëndësishëm është roli i tyre në formimin e përditshëm të fëmijëve, do të jenë modele të tjera, jashtë ndikimit të tyre dhe ndoshta jashtë sistemit të tyre të vlerave që djemtë e tyre do zgjedhin të ndjekin.

Nëse janë një model pozitiv për djemtë, baballarët janë edhe një model që ndikon gjerësisht në shoqëri dhe tek baballarët e ardhshëm.

Përveç edukimit në komunitet, ka edhe një sërë faktorësh në nivel individual, organizativ, komunitar dhe shoqëror që kontribuojnë në formimin e qëndrimeve të komunitetit për dhunën kundër grave (p.sh. ekspozimi ndaj dhunës që në fëmijëri, disa mjedise organizative dhe aktivitete moshatarësh). Kjo sugjeron edhe rëndësinë e eksplorimit të një game më të gjerë për një strategji të ndërhyrjes së hershme dhe bashkërendimin e iniciativave edukative formuese në nivel kombëtar dhe lokal. Informacionet mbi atë se ku te drejtohem për ndihmë duhet të jenë të ditura e te aksesueshme nga të gjithë. Kjo sugjeron nevojën për promovimin e modeleve pozitive lokale mes njerëzve më të pjekur të cilët do të përcjellin mesazhin anti-dhunë në komunitetet e tyre, si dhe për forcimin e sanksioneve ligjore dhe sociale në rastet e DhBGj.

Programet e zhvillimit të lidershit për individët në të gjithë institucionet vendore, të tilla si shëndetësia, arsimi, policia, dhe nga komuniteti i biznesit, mund të jetë efektive në inkurajimin e njerëzve për të parë përtej shqetësimeve të ngushta të profesionit të tyre dhe të punojnë së bashku në gjetjen e mënyrave më të mira për të promovuar barazinë gjinore dhe të udhëheqin drejtimet anti-DhBGj. Ky studim propozon një qasje për një qëllim të përbashkët me lidership në komunitet dhe përtej kufijve profesionale. Për të arritur këtë, duhet më tepër punë në edukimin mbi të drejtat e njeriut, dhe kjo të jetë e shtrirë vazhdimisht, gjerësisht në të gjitha institucionet derisa të bëhet pjesë e strukturave ekzistuese të tilla si shëndetësia dhe sistemi arsimor, strukturat e pushtetit vendor, forcave të policisë, burgjet, gjyqësorit, etj.

Një rol i rëndësishëm i përket edhe mediave etike, jo vetëm për raportimin e rasteve të dhunës, por edhe në theksimin e ndëshkimit dhe mosmiratimit të dhunës përmes fushatave sociale që adresojnë dhunën kundër grave. Dhënja e informacionit në lidhje me impaktin e raportimit të dhunës në familje për të inkurajuar rritje të raportimeve duhet të shtrihet si pjesë e rritjes së vetëdijes edukative edhe për gazetarët. Kjo do të thotë komunikim në shkallë të lartë me komunitetin se dhuna është e papranueshme dhe perben shkelje të të drejtave të njeriut, pavarësisht nga prejardhja kulturore e dhunuesit apo viktimës. Dhënja e informacionit në lidhje me të drejtat dhe çfare ndihme egziston për ata që janë prekur nga dhuna duhet të fillojë duke sensibilizuar median në lidhje me të drejtat e njeriut.

Një rekomandim po aq i rëndësishëm rezulton nga ky studim - fushata anti DhBGj duhet të jetë e fokusuar në gjetjen e modeleve nga jeta e përditshme të cilët do të ndikojnë në jetën e djemve. VIP-at që promovojnë mesazhe në fushata të vecanta nuk ndikojnë në afat të gjatë shoqërinë, veçanërisht sepse

vlerat e tyre jo gjithmonë njihen apo pranohen nga një komunitet i caktuar. Akoma më pak me ndikim kanë mesazhet nga elitat politike, perkundrazi, punëtoritë treguan se angazhimi agresiv politik që i ushqehet përditë konsumatorëve të medias, bën të kundërtën e promovimit të mos përdorimit të dhunës. Kjo na çon në përfundimin, se fushata kundër dhunës përveç se ndaj mediave etike, duhet të drejtohet edhe tek elitat politike. Ato duhet të punojnë për të rritur ndërgjegjësimin për promovimin e modeleve pozitive në atë që politika i transmeton popullatës se gjerë, dhe sidomos ndikimin mbi mendjen e rinisë. Kjo gjë bëhet shumë e rëndësishme kur konsiderojmë që të rinjtë janë konsumatorë të medias edhe përmes rrjeteve sociale. Mesazhet që vijnë nga elitat e politikanëve marrin një rëndësi më të theksuar kështu që ata duhet të tregojnë përgjegjshmëri etike për të cilën u detyrohen qytetarëve të tyre, votuesve të tanishëm dhe të ardhshëm.

Pjesëmarrësit në punëtori dhe rrjetet sociale diskutuan dhe sollën në vëmendje nevojën për stimuj pozitivë për të promovuar angazhimin e meshkujve në çështjen e DhBGj. Dy ide kryesore u diskutuan: ideja për të festuar Ditën Kombëtare të Babait, me propozime të ndryshme mbi datën dhe mbi mënyrën e festimit (e diela e tretë e qershorit ; 8 Maj, etj); dhe ideja e pasjes së një simboli kombëtar për ditën kundër DhBGj. Rreth 90% e të anketuarve mirëpritën idenë për të pasur një ditë të babait, edhe pse disa baballarë nuk e panë këtë të nevojshme apo nuk arritën të qartësohen si kjo ide ishte e lidhur me çështjen. Ne nxitëm diskutimin se perse në ndryshim nga dita e nënës, dita e babait nuk ishte bërë zakon në Shqipëri. Një pjesë burrash në një grup u shprehën me humor se kjo ishte për shkak se pothuajse çdo ditë është dita e babait. Propozimet nga aktivitetet për një simbol kombëtar anti DhBGj u përqëndruan në diskutimin mbi sugjerimin e bërë nga një baba nga Durrësi i cili propozoi si simbol kombëtar të ditës kundër DhBGj një gjethe borziloku si një simbol i dashurisë dhe pastërtisë, sidhe pershtatja e simboleve nderkombetare psh. fjongoja e bardhe.

Nga këndvështrimi i institucioneve që punojnë kundër DhBGj, duhet të ndergjegjësohemi mbi ndikimin e mundshëm transformues të festimeve të tilla. Për shembull, në Gjermani dita tradicionale e festës së baballarëve ka ndryshuar nga të qenit fillimisht një ditë në të cilën burrat dalin për të pirë të gjithë së bashku, në një ditë që njerëzit ia dedikojnë dhe angazhohen në aktivitete me familjen e tyre. Kështu, QSSL përmes këtij studimi shpall thirrjen e hapur për mbështetje për festim të një Dite Kombëtare të Baballarëve, si dhe për krijimin e një fushate ombrellë të vetme, të qartë, kombëtare për angazhimin e burrave dhe djemve kundër DhBGj.

Pyetësor

Eshtë e natyrshme për burrin të veprojë në mënyrë agresive	Po Jo S'di
Ndonjëherë të goditurit është e vetmja mënyrë për të shprehur ndjenjat tona	Po Jo S'di
Burri që nuk lufton kur e nënvleftësojnë do të humbasë respektin si burrë	Po Jo S'di
Dhuna ndodh edhe në rast se nuk ka dëmtime fizike	Po Jo S'di
Gjithkush duhet të kontrollojë inatin gjatë një shერი	Po Jo S'di
Burrat mund të kujdesen për fëmijët po aq mirë sa dhe gratë	Po Jo S'di
Burri duhet të ketë fjalën e fundit për vendimet në familje	Po Jo S'di
Nëse dikush më fyen, do ta mbroj reputacionin tim edhe me dhunë nëse do duhet	Po Jo S'di
Gruaja duhet të tolerojë dhunën për të mbajtur familjen të bashkuar	Po Jo S'di
Nëse sheh një burrë që godet një grua duhet ta ndalosh	Po Jo S'di
Një burrë gjithmonë meriton respektin e gruas dhe fëmijëve të tij	Po Jo S'di
Mbi të gjitha një burrë ka nevojë për respekt	Po Jo S'di
Se si burri e trajton gruan e tij është punë për të	Po Jo S'di
Burri nuk duhet të ngrëjë kurrë dorë ndaj gruas	Po Jo S'di
Partnerët në një marrëdhënie duhet të trajtojnë njëri-tjetrin me respekt	Po Jo S'di
Burri dhe gruaja duhet të kenë role të barabarta në familje	Po Jo S'di
Secili partner duhet të ndjehet i lirë të dalë me shoqërinë e vet	Po Jo S'di
Eshtë e drejtë të godasësh, në rast se ju kanë goditur	Po Jo S'di
Njeriu duhet të jetë i lirë të veshë ç'të dojë	Po Jo S'di
Kur një burrë dhe një grua martohen, gruaja bëhet pronë e burrit	Po Jo S'di
Burri dhe gruaja duhet të ndajnë përgjegjësinë për drejtimin e shtëpisë	Po Jo S'di
Edhe kur marrëdhënia është e dhunshme, gruaja duhet të qëndrojë për hir të familjes	Po Jo S'di
Nëna dhe babai kanë përgjegjësi të përbashkët për rritjen e fëmijës	Po Jo S'di
Tradita e do që burri, si kreu i familjes, të nderohet	Po Jo S'di
Burri duhet të marrë vendimin në lidhje me paratë e shtëpisë edhe kur nuk i fiton vetë	Po Jo S'di
Kush ushtron dhunë? (Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)	- Kryesisht burrat - Të dy, por kryesisht burra - Si burrat, ashtu dhe gratë - Të dy, por kryesisht gratë - Kryesisht gratë - Nuk jam e/i sigurt
A kaloni kohë mjaftueshëm me [fëmijët/baba..] tuaj?	
A i transmetoni djalit vlerat tuaja për jetën?	Po Jo S'di
Çfarë aktivitete bëni me djalin (p.sh. sport, etj)	Pyetje e hapur
Çfarë mësimi të çmuar do të dëshironit t'i kaloni djalit tuaj?	Pyetje e hapur